



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court  
Adresa: Perandori Justinian, PN, Prishtinë  
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)

Prishtinë, datë: 15 dhjetor 2009  
Ref.: Nr. MP-04/09

**VENDIM**  
mbi Kërkesën për Masa të Përkohshme  
për

**Rastin Nr. KI. 27/09**

**Rafet Hoxha**  
kundër  
Vendimit të Gjykatës Supreme Nr. Pn. Nr. 168/2005

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Në përbërjen për sa vijon:

Enver Hasani, kryetar  
Snezhana Botusharova, gjyqtar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Iliriana Islami, gjyqtar  
Kadri Kryeziu, gjyqtar  
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar, dhe  
Altay Suroy, gjyqtar

me z-shën Albana Sopi si procesmbajtëse e Gjykatës në këshillimin e votimin e datës 25 nëntor 2009 lidhur me kërkesën për vënien e masës së përkohshme në rastin NO. KI 27/09 të nisur nga:

**Kërkuesi**

1. Kërkues është Rafet Hoxha, i përfaqësuar nga Hamdi Podvorica, avokat nga Prishtina.

**Objekti i shqyrtimit**

2. Më datën 13 korrik të vitit 2009, Kërkuesi ka dorëzuar parashtresë në Gjykatë.

Në këtë parashtresë, Kërkuesi ankohet se të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur përmes Vendimit të Gjykatës Supreme Nr. Pn.Nr 168/2005, të datës 7 korrik 2005 (në tekstin e mëtejshëm: Vendimi i Gjykatës Supreme).

3. Më 13 tetor 2009, Kërkuesi plotësoi parashtresën e tij me një kërkesë për masë të përkohshme e cila në mënyrë specifike kërkon pezullimin e procedurës për transferimin e tij në Norvegji, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

### **Baza juridike**

4. Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe neni 52 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

### **Faktet**

5. Vendimi i Gjykatës Supreme ka konfirmuar Vendimin Kp.Nr. 120/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, me të cilin përcaktohen se janë përmbushur të gjitha parakushtet ligjore për ekstradimin e Kërkuesit në Norvegji, të përcaktuara me Marrëveshjen e datës 22 tetor 2004, të arritur mes UNMIK-ut dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë.

6. Marrëveshja e lartpërmendur e arritur mes UNMIK-ut dhe Mbretërisë së Norvegjisë përcakton dorëzimin e Kërkuesit në Mbretërinë e Norvegjisë, pasi që autoritetet norvegjeze kanë nisur procedurë penale kundër Kërkuesit për veprë penale të vrasjes, për të cilën pretendohet të ketë ndodhur më 31 mars të vitit 2003.

7. Më 13 korrik të vitit 2009, Kërkuesi ka dorëzuar parashtresën në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e Vendimit të Gjykatës Supreme.

8. Më 13 tetor të vitit 2009, Kërkuesi ka plotësuar parashtresën me argumente tjera në favor të tij, duke kërkuar nga Gjykata që të miratojë masën e përkohshme dhe të pezullojë ekstradimin e tij në Norvegji. Në veçanti, Kërkuesi thekson se avokati i tij i mëparshëm që e ka përfaqësuar para Gjykatës Supreme ka bërë gabim duke mos i dorëzuar gjykatës dëshmitë mbi shtetësinë Kosovare të Kërkuesit.

### **Ankesat e parashtruesit të kërkesës**

9. Kërkuesi është ankuar se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Nenin 35 (4) si dhe Nenet 17, 18 dhe 22 të Kushtetutës. Posaçërisht duhet rikujtuar se Neni 35 (4) i Kushtetutës përcakton se "Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe."

10. Sipas Kërkuesit, shkelja e aluduar e të drejtave të tija kushtetuese përbën bazë të mjaftueshme për miratimin e masës së përkohshme nga Gjykata.

## GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi ka dëgjuar gjyqtarin raportues Ivan Çukalović, dhe pasi ka diskutuar Kërkesën e parashtrës të tjera të Kërkuesit për vënien e masës së përkohshme, ka bërë këshillimin më 25 nëntor 2009. Gjykata ka arritur tek konkluzioni se Kërkesa për vënien e masës së përkohshme nuk është e bazuar. Kërkuesi nuk ka ofruar asnjë provë për të provuar pohimet se ekstradimi i tij mund të rezultojë me dëmtime të parikuperueshme për të, dhe në veçanti pohimet se pas ekstradimit të tij në Norvegji ai do të përballej me trajtim çnjerëzor dhe denigrues, në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### PËR KËTO ARSYE


Kjo Gjykatë, në pajtim me nenin 116(2) të Kushtetutës, nenin 27(1) të Ligjit, si dhe nenin 52(1) të Rregullores së punës, njëzëri

### VENDOSI

- I. Të REFUZOHET kërkesa për vënien e masës së përkohshme;
- II. Palët do të njoftohen me këtë Vendim.
- III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**

Prof. Dr. Ivan Çukalović



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani

